



**VENDIM**

**Nr. 111 Datë 01.10.2013**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISE WONDER SH.A PËR TRANSFERIMIN E LIÇENSËS SË  
PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERGJISE ELEKTRIKE NGA  
SHOQERIA WONDER POWER SH.A TEK SHOQERIA “BHP ENERGY”  
SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20, pika 1 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 17, të Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të Liçensave, pikës 1.3 të Licencës së aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të ERE në mbledhjen e datës 01.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për transferimin e licenses së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Wonder Power“ Sh.a, shoqërisë “BHP Energy” sh.p.k.
2. Të fillojë procedurat për transferimin e licenses të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Wonder Power“ Sh.a, shoqërisë “BHP Energy” sh.p.k.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërive Wonder sh.a, Wonder Power sh.p.k dhe BHP Energy sh.p.k për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjehere dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë  
Shkëlqim Bozgo**

